



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr.60/01-11529/26
Kaçanik, 26.05.2026

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **V (pestë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatora e 8 e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 26.05.2026, në ora 11:00. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve të KK, me fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF prej 7 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 7 anëtarët-të gjithë: Selajdin Troni, Lejla Muhaxheri- Çaka, Bashkim Krasniqi, Kadrije Lika Troni, Ernesta Krasniqi, Ardita Rrahmani, Kjani Zeneli.

Nga Ekzekutivi i Komunës ishin: Nënkryetari i Komunës, 08 Drejtorët e Drejtorive, me përjashtim të drejtorit të DA. Nga zyrtarët: Asistentja e Kryesuesit, Zyrtarja për punë të KK.

Nga OSBE, mbledhjen e monitoroj, Faruk Dërmaku.

Mbledhjen e kryesoj, Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit.

Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare e Lartë për Punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit- Selajdin Troni, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, prezentë janë 7 anëtarët-të gjithë, materialin e keni marrë, e hapi mbledhjen e V (pestë) të rregullt të KPF-së për vitin 2026, data 26.05.2026, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozim Vendim për aprovimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për Komunën e Kaçanikut 2026-2030;
3. Propozim Vendim për emërimin e komisionit përzgjedhës për drejtor dhe zëvendësdrejtor të institucioneve arsimore;
4. Propozim Vendim për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në Buxhetin e Komunës për vitin 2026;
5. Propozim Vendim për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK Bob;
6. Propozim Vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në procesin e Emërtimit, Riemërtimit të Rrugëve dhe Numërimit të Adresave për territorin e komunës së Kaçanikut si dhe Emërtimin e Objekteve komunale;
7. Draft Rregullore për transport rrugor në territorin e komunës së Kaçanikut;

8. Propozim Vendim për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK Kaçanik.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë Rendin e punës, e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 7. Konstatohet se KPF

APROVOJ

Rendin e punës prej 8 pikave.

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Politikë dhe Financa;

Procesverbali i mbledhjes se kaluar të KPF u aprovua njëzëri pa vërejtje. Prezentë 7. Konstatohet se KPF

APROVOJ

Procesverbalin e mbledhjes se 5 (pestë) të rregullt të KPF të datës 23.04.2026/ Lënda: 01Nr.060/01-8863/26.

2. Propozim Vendim për aprovimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për Komunën e Kaçanikut 2026-2030;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika Troni: Kërkoj nga drejtoresha e DZHET- Arlinda Rakoci-Raka, me na dhënë sqarime me në detaje të strategjisë.

znj. Arlinda Rakoci-Raka: Në këtë Strategji janë përcaktuar prioritetet kryesore, zhvillimi ekonomik lokal i komunës. Prioritetet janë: përkrahja e bizneseve, krijimi i vendeve të punës, përmirësimi i infrastrukturës, zhvillimi i bujqësisë, zhvillimi i turizmit, sa me tepër shërbime cilësore për qytetarë. Këto prioritete janë përcaktuar në përputhje me nevojat dhe potencialin zhvillimor të komunës së Kaçanikut. I mirëpresim sugjerimet e juaja.

znj. Kadrije Lika Troni: Një strategji e tillë a ka ekzistuar edhe me herët apo vetëm tani? Kush e ka hartuar këtë strategji, a vjen material në nivel qendror në bazë të specifikave të komunës, apo kush e harton?

znj. Arlinda Rakoci-Raka: Po, ka pasur Strategji për zhvillimin e komunës çdo 4 vite. Për këtë Strategji është kontraktuar një kompani dhe grupi punues për hartimin e saj. Në strategji janë materialet e inkorporuar nga secila drejtori, secili prej tyre e ka siguruar materialin e kërkuar në fushën e tyre. Para aprovimit mundem me inkorporuar nëse keni ndonjë diçka tjetër që mendoni se duhet të përfshihet në këtë dokument.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë Draft Strategji e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 7. Konstatohet se KPF

Aprovoj

Propozim Vendim për aprovimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për Komunën e Kaçanikut 2026-2030.

I rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe Aprovim.

3. Propozim Vendim për emërimin e komisionit përzgjedhës për drejtor dhe zëvendësdrejtor të institucioneve arsimore;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika Troni: Unë e kam kërkesë që kur të zgjidhet komisioni, të mos jetë partiak. Drejtorët dhe zëvendësdrejtorët që zgjedhën, të jenë persona që kanë eksperiencë, menaxhim, dhe që lënë përshtypje të mira në punë, e jo me i zgjedhur personat politik.

Kryesuesi i Kuvendit: Në komision ka edhe përfaqësues nga ministria.

znj. Kadrije Lika Troni: Në komision është një përfaqësues nga ministria, por për fat të keq, shumica e drejtorëve, zëvendësdrejtorëve në shkolla janë partiak.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk janë në krejt shkollat drejtorët dhe zëvendësdrejtorëve persona partiak. Diskutime tjera nuk ka, a jeni që kjo pikë me shkuar në KK. Njëzëri ishin Për. Prezentë 7. Konstatohet se KPF,

Aprovoj

Propozim Vendim për emërimin e komisionit përzgjedhës për drejtor dhe zëvendësdrejtor të institucioneve arsimore.

I rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe Aprovim.

4. Propozim Vendim për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në Buxhetin e Komunës për vitin 2026;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika Troni: Bartja e mjeteve është nga vitet paraprake, ndërkaq ne po kemi problem me mjete buxhetore. A barten vetëm mjetet e vitit 2025, apo barten edhe nga vitet tjera.

Kryesuesi i Kuvendit: Fjalën e ka drejtori i DBF, Valdrin Dogani

z. Valdrin Dogani: Mjetet barten nga viti 2025, por ka edhe mjete të vitit 2024 që bartën, të cilat mjete nuk janë shpenzuar. Krahasuar me vitin e kaluar, sivjet është niveli me i ulët i mjeteve që bartën, janë 430,535.34€ nga të HVK, ndërkaq në vitin e kaluar janë bartur mbi 1 milion euro. Të HVK janë e drejtë ekskluzive e komunës për shfrytëzim, varësisht prej obligimeve kontraktuale të komunave.

znj. Ernesta Krasniqi: Mjetet që bartën nga viti 2024 në vitin 2026 janë 118,961€.

z. Valdrin Dogani: Mjetet që bartën nga viti 2024 në vitin 2026, janë 118,961€, ndërkaq nga viti 2025 në vitin 2026 janë 311,573.35€, përfshirë edhe tejkalimin e të hyrave vetanake në shumë 87,692.540128. Gjithsej mjete të pashpenzuara që barten nga vitet paraprake janë 430,535.34€.

znj. Ernesta Krasniqi: Këto janë vetëm në kategoritë që kanë me u bartur?

Valdrin Dogani: Janë kategoritë që kanë me u bartur, por janë detajet në programe buxhetore-drejtore. Të pika 5, për mallra dhe shërbime bartet shuma 102,282.04€, të cilat mjete bartën në nën programet buxhetore si vijon: administrata 20,000€, shërbimet publike 42,282.04€, zjarrfikësit 5,000€, DUKMM 15,000€ dhe të DKRS 20,000€. Të kategoritë e shpenzimeve komunale, shuma 54,808.58€ shpërndahet në programet buxhetore si vijon: 15,000 administrata, 10,000€ të DSHPE, arsimit fillor 17,000€, arsimit mesëm 12,808.58€. Për secilën kategori mundem me i dhënë në detajet arsyetimet pse jemi duke i bartur.

znj. Ernesta Krasniqi: Këto mjete janë nga të HVK. A mundem me ditur kategoritë që nuk janë shpenzuar këto mjete?

Valdrin Dogani: Janë në tabela në fund, f.5, tabela nr.1. Bilancet e pashpenzuara nga fondi 21 nga të HVK për vitin 2025, janë mjetet sa kanë mbetur të Zyra e Kryetarit është vlera 3,791.12€, Administrata dhe të shërbimet tjera e kështu me radhë.

znj. Ernesta Krasniqi: Këto mjete që bartën a janë vetëm të vitit 2025, apo edhe të vitit 2024 ?

Valdrin Dogani: Tabela nr. 2 i paraqet mjetet e pashpenzuara të vitit 2024. Pastaj në tabelën me nr.3 janë përmbledhur bilancet e pashpenzuara, ndërkaq në tabelën me nr. 4, tregon sesi kanë me u shpërndarë këto mjete, ndërkaq tabela me nr. 5, paraqet detaje në shpërndarjen e mjeteve në projektet kapitale.

znj. Ernesta Krasniqi: Kërkoj sqarime të nevojshme për mjetet e parapara për projektin e nënkalimit për këmbësor nën hekurudhën e qytetit, shuma 8,107.25€.

z. Valdrin Dogani: Bëhet fjalë për mbulojen e nënkalimit për këmbësor nën hekurudhë. Faza e I-r ka pasur të bëjë me ndërtimin e nënkalimit, ndërkaq faza e II-të e kemi parapara me mbuluar nënkalimin, pasi që ka mjete.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë, dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 7. Konstatohet se KPF,

Aprovoj

Propozim Vendim për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në Buxhetin e Komunës për vitin 2026. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

5.Propozim Vendim për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK Bob;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Kjami Zeneli: Unë e ka vizituar këtë vend, e kam pa gjendjen në terren, është duke u bërë një punë e mirë aty.

z. Korab Krasniqi: Gjendja reale veç është, ne vetëm jemi duke e regjistruar gjendjen faktike.

znj. Kadrije Lika Troni: Kërkoj nga drejtori sqarime me në detaje dhe ku gjendet ajo pronë.

z. Korab Krasniqi: Kemi të bëjmë me një këmbim të pronës, në dy anët rreth shtëpisë është pjesa e rrugës publike. Për momentin pjesa kah skaji është pronë private, pjesa të trotuari është pronë e tij private, ka kërkuar me këmbyer me një pronë publike në afërsi të shtëpisë së tij, se nuk mundet me kryer as legalizimin, se shtëpia i del në dy qoshe në pronë publike, kështu komuna e merr pjesën e rrugës që nuk është pronë e vet dhe pjesën të trotuari me i bërë pronë publike, ku bëhet mirë për të edhe për legalizimin e objektit.

z. Kjani Zeneli: Prona është të Voskopoja, degëzimi i rrugës që lidhet me lagjen Zeneli, pjesa e komunës është e pashfrytëzuar, ndërkaq në pronën private të tij është rruga dhe trotuari. Ai e ka shprehur gatishmërinë për me këmbyer me komunën, ku përfitojnë dy palët, përfitimi me i madh është i lagjes.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë, dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 7. Konstatohet se KPF,

Aprovoj

Propozim Vendim për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK Bob. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

6. Propozim Vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në procesin e Emërimit, Riemërimit të Rrugëve dhe Numërimit të Adresave për territorin e komunës së Kaçanikut si dhe Emërimit e Objekteve komunale;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika Troni: A do të shqyrtohen edhe kërkesat e mëhershme për emërtim dhe riemërtim të rrugëve, se kur është marrë një vendim në legjislaturën e kaluar, janë përzgjedhur disa nga kërkesat. Disa kërkesa që kanë ardhur në fund ishin shqyrtuar, ndërkaq ka pasur kërkesa të mëhershme që nuk janë shqyrtuar.

z. Korab Krasniqi: Komisioni ka me pasur mandatin 4 vjet. Të gjitha kërkesat që janë, ia adresojmë KK dhe pas përfundimit të punës, i adresohen KK për shqyrtim dhe aprovim.

znj. Kadrije Lika Troni: Të objektet komunale, cilat objekte kanë me u emërtuar dhe qysh kanë me qenë propozimet?

z. Korab Krasniqi: Është fjala për disa objekte të paemërtuara, si Palestra sportive etj. Për mos me formuar komision të veçantë, ky komision ka me u marrë edhe me kërkesat për emërtimin e objekteve të komunës.

znj. Ernesta Krasniqi: A ka emra në listë të pritjes, për emërtimin e rrugëve?

Kryesuesi i Kuvendit: Po, ka emra në listë të pritjes për emërtimin e rrugëve.

z. Kjani Zeneli: Ka edhe rrugë që janë kontestuese.

z. Korab Krasniqi: Të emërtimi i objekteve, propozimet kanë me qenë prej komuniteteve ose prej drejtorisë përkatëse që i menaxhon ato objekte.

znj. Kadrije Lika Troni: A ka të drejtë secili qytetar me shpreh vullnetin për ndonjë emërtim të objekteve, siç është çështja e Palestrës sportive, pastaj komisioni i shqyrton?

z. Korab Krasniqi: Të emërtimet e rrugëve, shumica janë me propozim të komuniteteve, ndërkaq të objektet, anëtarët mund të jenë nga ai institucion. Unë mendoj se duhet me pasur një diskutim publik emërtimi i objekteve, se është çështje e ndjeshme.

z. Kjani Zeneli: Mendoj se duhet të kemi parasysh çështjen e emërtimit të komisionit, se është çështje e ndjeshme. Në komision kam dëshirë të përfshihen një përfaqësues nga tre OJQ e dala nga lufta e UÇK, se ka shumë emra të mëdhenj që mund të propozohen nga këto organizata.

Nënkryetari i Komunës-Xhelal Dema: Të krejt emërtimet duhet me qenë të kujdesshëm, se janë çështje të ndjeshme.

z. Korab Krasniqi: Ne, komisionin duhet me formuar se ka shumë kërkesa që presin me u shqyrtuar, pastaj gjatë procesit, komisioni vendosë për procedurën. Tani agjencia kërkon që fillimisht me u marrë emrat nga lista e pritjes, e jo me lënë emra qysh janë lënë me herët të gjyshërve të tyre. Këta emra gati se nuk pranohen më, se do të merren emra nga lista e pritjes me emra të dëshmuar të figurave historike.

znj. Ernesta Krasniqi: A ka emërtim të rrugës që është vendosur, ndërkaq nuk është ndryshuar ende në gjeoportat.

znj. Kadrije Lika Troni: Unë adresën time e kam rruga “UÇK”, tani ajo rrugë është hequr, ndërkaq nuk ka pasur mundësi me u hequr pa vendim të KK.

Kryesuesi i Kuvendit: Janë procesverbalet edhe mbledhja kur është mbajtur për atë rrugë.

znj. Kadrije Lika Troni: Tani kur kanë ardhur me na i regjistruar shtëpitë, ajo rrugë nuk u gjente askund, ndërkaq unë kam dokumentet me atë rrugë.

Kryesuesi i Kuvendit: Rruga “UÇK” ka qenë deri të rruga “Mynyr Thaqi”, ndërkaq në KK është ndryshuar, tani e kemi nga Çakët deri në hyrje të Biçecit, është rruga “Izahir Troni”, ndërkaq andej sa e di unë vazhdon rruga “Sadik Guri”.

znj. Kadrije Lika Troni: Nuk jam kundër riemërimit, por duhet të merret pëlqim nga banorët. Është dashur se paku me bërë një njoftim për ndryshimin e rrugës. Sido që të jetë ne pajtohëm me emërtimin, kemi shumë respekt për familjen, për emrin, ndërkaq gabimet nuk është mirë që po ndodhin. Kam informatë se edhe në Stagovë, është hequr emërtimi i një rruge. Sigurisht se jeni të njoftuar, dhe kjo krijon konflikt në mes të familjeve, kështu që komisioni duhet me qenë shumë i kujdesshëm.

z. Korab Krasniqi: Nuk ka mundësi me u ndryshuar emërtimet e rrugëve, pa pasur një nënshkrim të administratorit të fshatit.

Kryesuesi i Kuvendit: Ajo rrugë nuk është e fshatit Kovaçec, është rrugë që lidhë shumë fshatra. Vendimin e ka marrë KK. Zakonisht kur bëhen ndryshime, njoftohet administratori i fshatit, por kjo rrugë nuk bëhet nga administratori i fshatit, por bëhet nga KK, pa marrë pëlqim nga administratori, si rruga komandant “Bardhi” etj.

Nënkryetari i Komunës: Duke dashur me nderuar dike, ka mundësi që po krijohet konflikti mes tyre.

znj. Kadrije Lika Troni: Pa pëlqim dhe pa njoftim të banorëve, mendoj se nuk mund të ndryshohet emri i rrugës se pastaj mund të lindin probleme sikurse me Stagovën që ka ndodhur.

Kryesuesi i Kuvendit: Për degëzime të rrugëve, duhet merret pëlqim nga administratori dhe të nënshkruhet nga ta. Kemi pasur rastin e Biçecit, nuk e kanë nënshkruar pëlqimin për me ndryshuar emërtimin dhe ka ngelur emërtimi i mëhershëm, ndërkaq banorët janë të pakënaqur.

znj. Kadrije Lika Troni: Jam duke ju kuptuar që dallojnë rrugët regjionale me rrugët brenda fshatit, por po flas për ndryshimet e emërtimeve të rrugëve. Komisioni duhet me qenë shumë vigjilentë, përndryshe unë e mbajë me krenari atë emërtim, por çështja është e procedurave që janë bërë pa pëlqim dhe njoftim të komunitetit.

z. Korab Krasniqi: Emërtimet e sakta të rrugëve janë ato që dalin në gjeportal.

znj. Kadrije Lika Troni: Me shikuar në gjeportal, rruga "Izahir Troni", del diku kah Kukajt, ndërkaq tani për tani unë adresë të saktë të rrugës nuk kam.

z. Korab Krasniqi: Duhesh me ardhur me bërë kërkesë me ta vendosur numrin e rrugës.

znj. Kadrije Lika Troni: Në momentin që është ndryshuar emri i rrugës, komplet numrat e asaj lagueje janë gabim. Këto duhet me u rregulluar.

z. Korab Krasniqi: Në sistem janë numrat e adresave.

znj. Ernesta Krasniqi: Numrat e adresave të shtëpive nuk janë në sistem.

Kryesuesi i Kuvendit: Pjesa kah Nikaj, është rruga "Sadik Guri", pjesa e rrugës 25 Maji që është nga kryqi i Tushaj, të rruga e re deri të ura e Banovinës, është rruga e UÇK, d.m.th. rrugët nisin nga rruga "Vëllezërit Çaka" "Izahir Troni" deri në Biçec, degëzimi i rrugës "Feriz Guri". Pjesa tjetër është rruga "Sadik Guri". Si familje kemi dashur kur na është kërkuar me ndërprerë rrugën, që mos me pasur konflikt brenda familjeve të dëshmorëve. Të pjesa e rrugës afër shkollës, unë kam kërkuar me u bërë rruga "Katër Dëshmorët", që me u bërë një bashkim i familjeve të dëshmorëve. Janë rregulluar rrugët me emrat "Minir Thaqi", "Raif Koraqi", "Ekrem Ahmetaj" për mos me pasur konflikt. Tani kemi kërkuar një rrugë me u bërë "Katër Dëshmorët" -është një degëzim i vogël i një rruge në atë pjesë, kuptohet me pëlqimin e administratorit.

z. Korab Krasniqi: Komisioni është i nevojshme me u formuar për emërtim dhe riemërtim të rrugëve.

z. Kjani Zeneli: Ne nuk jemi me krijuar probleme, ndërkaq kërkoj që komisioni të jetë gjithëpërfshirës.

Nënkryetari i Komunës: Komisioni i cili do të formohet, mendoj se duhet me qenë me integritet, me pasur njohuri në këtë fushë dhe me qenë i vëmendshëm në punën e tij.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk e di a kemi me pasur problem të lista e pritjes, a kanë me na kaluar do emra që propozohen, pa u krye lista e pritjes, se janë 20% të listës së pritjes që duhet me u përfshirë.

z. Arian Teneqja: Po, e vërtetë është kryesues.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 7. Konstatohet se KPF,

Aprovoj

Propozim Vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në procesin e Emërimit, Riemërimit të Rrugëve dhe Numërimit të Adresave për territorin e komunës së Kaçanikut si dhe Emërimit e Objekteve komunale; Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe Aprovim.

7. Draft Rregullore për transport rrugor në territorin e komunës së Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika Troni: Nuk kam arritur Mua me intereson me ditur a është përfshirë regjioni me linja të rregullta, se ka linja që nxënësit nuk i përshtatet orari, se nxënësi duhet ardhur 30-45 minuta me herët, ata duhet me u shëtitur nëpër kafiteri deri në orarin e mësimi. Kjo formë e mësim nxënies nuk është e mirë, se nxënësit lodhen deri sa të iu vjen koha me filluar mësimin, por edhe për prindërit nuk është mirë që fëmijët me iu ndenjor rrugëve. Nxënësit e f. Llanishtë a e kanë të sigurt transportin 100%. Kemi folur me herët edhe me drejtorin se deri tani e kanë pasur 50:50, ku 50% i ka paguar prindi, ndërkaq ne e kemi obligim që fëmijëve në zona të thella rurale me ua paguar transportin, ku në këtë rast vetëm Llanishta paguan 50:50%. Jetoni që ka bërë një kërkesë për transportin e nxënësve në Dragomas, unë isha para disa ditëve në atë vend, ai vend ishte larg.

Kryesuesi i Kuvendit: Jetoni e ka bërë gabim kërkesën, se nuk është 4km, se ka rrugë anësore me të shkurtër, që nuk i vjen as 1 km. Besoj se një përgjigje ua kthen drejtori i DA.

znj. Kadrije Lika Troni: Transport duhet me pasur ata nxënës, se mësimi nuk zhvillohet vetëm verës në rrugë të shkurta, se varet terreni qysh është.

Kryesuesi i Kuvendit: Fjalën e ka drejtori i DSHPE, Arian Teneqja.

z. Arian Teneqja: Ne e kemi pasur rregulloren e transportit rrugor të miratuar në muajin qershor 2025. Vlerësimi i ligjshmërisë është vonuar dhe është publikuar rregullorja. Ministria ka kërkuar të rishqyrtohet rregullorja edhe një herë, edhe pse ka kaluar afati ligjor dhe e kemi rishqyrtuar. Në këtë rregullore janë paraparë format e licencimit-dhënia e linjave. Atë çka po thotë Kadrija, oraret nuk përcaktohen në këtë rregullore, janë format ligjore sesi epën licencat. Nëse ka vërejtje, është sektori i komunikacionit, Rregullorja i përcakton sesi merren licencat. Për zbatimin e kësaj rregulloreje, kujdeset DSHPE.

znj. Kadrije Lika Troni: Transporti nxënësve po iu paguhet, ndërkaq autobusët janë të mbushur me qytetarë, nuk e di a ka inspektor me i kontrolluar. Kjo është problem serioz, se ne kur të marrim një vendim, ai vendim duhet të jetësohet, se kjo ndikon edhe në çështjen e sigurisë së nxënësve, se linjat nuk janë shtuar.

z. Arian Teneqja: Kompania kur e merr lejen, e ka të përcaktuar sesa pasagjer lejohen. Nëse ka mbi numrin e përcaktuar të ulëseve, atëherë gjobitet-dënohet. Për këtë janë përgjegjës inspektorati i komunikacionit dhe policia e Kosovës, të cilët dalin në terren dhe bëjnë inspektime.

znj. Kadrije Lika Troni: Kontrata kur është nënshkruar, a ceket se ai autobus i bartë vetëm nxënësit?

z. Arian Teneqja: Jo, kompania e ka për obligim me i bartur nxënësit në atë orar. Nëse shtohet kapaciteti, duhet inspektori me u marrë me këto punë.

z. Bashkim Krasniqi: Nuk dobësohet kapaciteti pse bartë edhe qytetarë. I njëjti nxënës ka udhëtuar kur iu ka paguar transporti nga komuna dhe kur ka paguar nxënësi.

Kryesuesi i Kuvendit: Është problem i kompanisë qysh e bënë zgjidhjen.

znj. Kadrije Lika Troni: Çështja është se kapacitetet nuk janë shtuar, ndërkaq nxënësi duhet me u ndier komod në autobus, jo me mbetur në këmbë. Tani që jemi duke ua paguar ne si komunë, nxënësi duhet me qëndruar me komod në autobus.

Nënkryetari i Komunës: Secili duhet me pasur ulësen e vet, pavarësisht a paguan vet apo ia paguan komuna transportin.

z. Arian Teneqja: Edhe qëndrimi në këmbë është i lejuar, është i përcaktuar kur lejohet me qëndruar në këmbë udhëtari, kur jo. Në rrugë urbane lejohet, në regjionale nuk lejohet. Janë organet që duhet me u marrë me këtë punë.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri për. Prezentë 7. Konstatohet se KPF,

Aprovoj

Draft Rregullore për transport rrugor në territorin e komunës së Kaçanikut. Kjo Draft Rregullore i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

8. Propozim Vendim për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Kjami Zeneli: Kërkoj që kjo pikë të hiqet nga rendi i punës, se jam pak a shumë në ngjarje se kjo pikë mund të krijon probleme. Ne jemi këtu me zgjidhur probleme, jo me krijuar probleme. Unë sot jam takuar me familjarët e këtyre pronave, e di se kjo çështje ka mundësi me krijuar probleme në mes të dy familjeve. Toka është marrë në Dushkajë, ndërkaq kompensohet në qytet. Unë nuk jam kundër këtyre familjeve, por jam kundër problemeve që mund të ndodhin, se bash sot një familjar i familjes Begunca me është drejtuar me fjalë jo shumë të mira në tavolinë. Unë jam me hequr këtë pikë derisa të zgjidhet problemi, pastaj me votuar dhe me ecur përpara.

znj. Ardita Rrahmani: Kjo pikë ka qenë në rend pune edhe në një mbledhje të KPF dhe kemi arritur pëlqimin që me hequr nga rendi i punës, është tërhequr pa e diskutuar. A ka ndërëruar diçka gjendja reale nga koha kur e kemi tërhequr këtë pikë? Unë e di se për këtë çështje janë në proces gjyqësor personat. Pasi të përfundon procesi gjyqësor, të na vjen për diskutim, e votojmë.

znj. Kadrije Lika Troni: Nëse kjo çështje është në procedurë gjyqësore, ne nuk kemi të drejtë me trajtuar.

znj. Ardita Rrahmani: Janë dy palë beguncë, ata që duan me bërë këtë këmbim dhe ata që janë kundër këtij këmbimi. Jo që jam kundër me ua kryer këtë çështje beguncëve, por duhet

të kryhet paraprakisht puna me tushajt, se beguncët me tushajt janë në një proces gjyqësor. Nëse kryhet procesi gjyqësor në favor të beguncëve, atëherë unë nuk jam kam kundër aprovimit të kësaj pike.

znj. Kadrije Lika Troni: Drejtor, a po na tregon pse e keni tërhequr pikën se edhe atë ditë nuk keni dhënë sqarime. a e keni ditur këtë rast, dhe a mendoni se është zgjidhur problemi për me ardhur kjo pikë në shqyrtim? E dyta, sipas dokumenteve që i kemi, e kam vërejtur se objekti që është në këmbim, është 1m2 në rrugë publike, çfarë katrahure është bërë qysh atëherë, 1m2 merret këtu me u kompensuar diku tjetër. Tjetra, e shtron rrugën private e bënë rrugë publike pa i zgjidhur problemet, pastaj këto probleme po na vinë këtu.

znj. Ardita Rrahmani: Për me pasur me të qartë, beguncët nuk kanë probleme mes veti.

z. Korab Krasniqi: Çështja që është tërhequr kjo pikë, në mungesë të informatave, kinse është lënda në proces gjyqësor. Prona me të cilën po synojmë me bërë këmbimin, nuk është në proces gjyqësor, është një pronë tjetër në proces gjyqësor me të. I kam takuar dy palët paraprakisht, ata e kanë një problem të tyre, ndërkaq këta që kërkojnë këmbimin, nuk kanë probleme mes veti me u shpallë kjo pronë me interes. Ajo që po thoni se është bërë katrahurë, objekti është pa leje, ai donë me bërë këtë këmbim, për me legalizuar objektin. Pjesa që ka kërkuar, është një pjesë e rrugës e shtruar, duke pasur nevojë të madhe për rrugë të reja, nuk janë përfillur të gjitha procedurat, është bërë me mirëbesim, qytetarët e kanë keqpërdorur mirëbesimin e komunës. Ata kanë kërkuar me iu shtruar rruga, pastaj e kanë shfrytëzuar të drejtën e vet për kompensim apo këmbim. I njëjti rast është të kjo, është rruga me e frekuentuar, është kjo pjesa lartë në Dushkajë, që figuron pronë private. E jona është me shqyrtuar, nëse ka telashe, mundemi mos me ekzekutuar.

z. Kjani Zeneli: Unë nuk jam i fushës, ne edhe mundemi me votuar në KK, ne dimë se qysh janë shtruar rrugët në Dushkajë, se ka qenë nevojë e kohës, por çështja është të raporti i kompensimit me 1m2 trotuar merret atje, ndërkaq kompensohet në qytet. Unë kam respekt për dy familjet, por duhet me i paraparë pasojat që mund të lindin pas kësaj, se mund të lindë konflikti me tushët. Unë mendoj që këto çështje duhet me u zgjidhur sot, që nëse nesër ndodhë një problem, dikush duhet me dhënë llogari. Ne mundemi me kaluar çështjen edhe në KK, por mendoj se kjo çështje duhet me u analizuar mirë, se pala ishte shumë e mllëfësuar, e mund të lind ndonjë problem në të ardhmen. Unë jam me iu bërë zgjidhje qytetarëve, jo me krijuar telashe. Unë ju kuptoj se si DUKMM aty akumulohen shumë probleme, por duke analizuar çështjen, me shikuar me nxjerrë me të mirën e mundshme, dhe e votojmë ashtu siç duhet. Materiali është në rregull, por çështja është të pasojat.

znj. Ardita Rrahmani: Edhe këmbimi është në rregull.

z. Kjani Zeneli: Këmbimi është në rregull, por pasojat mund të lindin me vonë.

znj. Ernesta Krasniqi: Drejtor ju po thoni se objekti është i pa legalizuar, ndërkaq legalizohet pas këtij këmbimi, por çështja është se në emër të kësaj mund të thirren edhe objektet tjera të pa legalizuara. Dokumentet siç shihet nuk kanë ndryshuar nga hera e parë që i kemi pasur në KPF, janë të njëjtat dokumente.

z. Korab Krasniqi: Jo nuk mundet, dokumentet janë të njëjta, ndërkaq unë e kam pasur informatën se janë në proces gjyqësor, ndërkaq nuk janë. Ju jeni ata që e votoni, nëse mendoni se nuk duhet me proceduar e mbajmë ende. Të pjesa e legalizimit, është rregull bazik që objektet duhet me qenë brenda pronës së vet, këtu nuk është. Në momentin që

bëhet këmbimi, ai mundet me legalizuar objektin. Objektet tjera nuk munden me marrë për bazë.

znj. Ernesta Krasniqi: Munden me marrë për bazë, duke u thirrur në këtë legalizim.

znj. Kadrije Lika Troni: Qysh parashihet ajo pjesë me PZHK? Ne po duam me i zgjeruar rrugët, sikurse qysh janë bërë atëherë, në vend se me pasur ide me zhvilluar qytetin. Me PZHK aty nuk parashihet të jetë objekt. Ne duhet interesin e komunës me pasur para interesit privat, e jo duke këmbyer pronat komunale duke i ngushtuar rrugët tona, si të NASA i japim një metër duke ngushtuar rrugët, atëherë çka jemi duke bërë si komunë. Në arteriet kryesore të qytetit në vend se me i zgjeruar, po i ngushtojmë. Në rrugën ‘Remzi Hoxha’, mendoj se interesi i komunës është me ia kompensuar me mjete, se njëherë ndërtohen objektet dhe me i rregulluar përgjithmonë, ju po thoni me ia dhënë 1 metër, që për mua kjo nuk ka kuptim. Unë jam mos me proceduar për KK këtë çështje.

z. Korab Krasniqi: Të ajo ndërtesë, gjendja faktike është gati 1m2 jashtë pronës së vet. Nëse ky objekt nuk legalizohet, në të ardhmen duhet me marrë hapa me prishur. Vendimin e marr KK. Sa i përket interesit publik, ne kemi rrugën “Qamil Ilazi”, është shpallë me interes dhe kemi kërkuar me u larguar nga rruga 7m, ndërsa nga rruga anësore 4m. Unë prioritet e kam me i rritur hapësirat publike, por në këtë rast gjendja faktike është kjo. Ne duhet me iu përshtatur pak edhe gjendjes aktuale si është. Askush nuk ka vullnet me shkuar me prishur atë objekt, nuk është e rrugës me ia prishur objektin e ndërtuar që 20 vite. Me profitabile është me ia njohur të drejtën e 1m2 e me ia marrë atë pronë të rruga, sesa me paguar dhe atë metër ai përsëri e shfrytëzon. Në rast se nuk e bëjmë këmbimin mundet me na paditur në gjyq, dhe paguajmë me para, ndërkaq ky e shfrytëzon këtë metër.

znj. Ardita Rrahmani: Ju si drejtor po duhet me u ballafaquar me një situatë të tillë, duke pasur parasysh se është një diçka që mundet me u prishur.

znj. Kadrije Lika Troni: E rëndësishme për palën është me legalizuar objektin, se me prishë mundet në çdo kohë. Problemi është ai me marrë 1m2. A e dini sa metra i kemi lejuar në vend që me zgjeruar arterien kryesore të qytetit, po e ngushtojmë me dorën tonë. Unë jam kundër kësaj. E ka bërë KK me herët, lë të bartin, unë nuk jam as me votuar as me dërguar në KK.

znj. Ardita Rrahmani: Mua po me vjen keq që po duhet ne me marrë këtë barrë, nëse ka mundësi që me shpëtuar një konflikt deri në një vendim të gjykatës, se po e shoh se ka pajtueshmëri mes kolegëve. A është me urgjencë me u krye në këtë mbledhje kjo çështje? Kush është duke u ngutur për këtë çështje? Nuk jam mos me u bërë legalizimi i atij objekti, nuk kam kundër ndaj asnjërit familje begunca, por çështja është të shpëtojmë një konflikt familjar. Pse me i prishur dy familje, kur ka mundësi me shtyrë kjo çështje. Kush është duke bërë presion me kaluar kjo pikë në këtë mbledhje.

Kryesuesi i Kuvendit: Pala ka kërkuar me shqyrtuar lëndën dhe ka të drejtë me kërkuar, është e drejta e tij.

znj. Ardita Rrahmani: Kjo pikë ka qenë në shqyrtim para dy muajve, a mundeni me na treguar çka ka ndryshuar nga ajo datë? Nëse nuk ka ndryshuar, pse e keni tërhequr atëherë?

z. Korab Krasniqi: Nuk ka ndryshuar asgjë dhe nuk mund të ndryshoj qoftë edhe një vit me kaluar. Është e njëjta gjendje se ai nuk e rritë objektin.

znj. Ardita Rrahmani: Dikush duhet me marrë një barrë që sinqerisht nuk i takon.

Kryesuesi i Kuvendit: Aty është problemi, tani po ju kuptoj juve.

znj. Ernesta Krasniqi: Ne krejt marrim mbi vete barra nganjëherë.

znj. Ardita Rrahmani: Ne jemi anëtarë të KK, ndërkaq dikush është kryetar, dikush është drejtor, për atë jemi këtu. Kështu që jam me bërë një zgjidhje, - me shtyrë për një mbledhje tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit: Sa i përket barrës, të gjithë marrim barra se jemi në punë. Edhe drejtori atë ditë që e ka nënshkruar kontratën ka me pasur probleme e telashe, se nuk mundemi me ardhur në punë e mos me iu dal ballë çështjeve. Drejtori është i vetëdijshëm për këtë. Sa i përket asaj që mos me hapur konflikt familjeve, unë jam edhe me shtyrë, por nuk vendosi unë.

znj. Ardita Rrahmani: Nëse familja që po kërkon me shtyrë, gjykata e nxjerrë vendimin e vet, në favor të palës krejt tjetër. Ata nuk po thonë se jemi kundër legalizimit, por të kryejmë njëherë këtë, pastaj vazhdojmë me tjetrën. Qysh do që të kryhet, legalizimi bëhet.

znj. Kadrije Lika Troni: Drejtor, unë mendoj se ligji dhe komuna janë institucion që veprojnë mbi interesin e qytetarit. Kur është interesi i komunës, e keni të drejtën ekskluzive me bërë marrëveshje, nuk të interesojnë problemet familjare që i kanë ata, por ku është interesi i komunës me dhënë 1m2? Është PZHK, ai nesër e legalizon dhe bënë diçka krejt tjetër aty.

znj. Ardita Rrahmani: Jo nuk mundet.

Kryesuesi i Kuvendit: Arsyetimin e keni Kadrije.

z. Kjani Zeneli: Prona është të bulevardit dhe vet fjala tregon se ajo pronë donë trajtim ndryshe. Ne jemi duke menduar me bërë një qytet të mirë me ndërtime të larta, dhe kur të bëhet me plan e ai e legalizon objektin. A është në gjendje komuna me ia paguar fjala vjen 1 milion euro që i kërkon pala. Për atë është mirë me bërë një zgjidhje të problemit. Dy familjet janë që respektohen në qytet, nuk njihen për probleme, ndërkaq ne si komunë në këtë rast mos po bëjmë ndonjë hap të gabuar dhe e krijojmë telashe mes familjeve, që ai vendim na përcjellë gjatë gjithë jetës. Nëse e bëjmë një zgjidhje të mirë, edhe ata edhe ne do të ndihemi gjithmonë mirë.

znj. Ardita Rrahmani: Çështja është që paraprakisht të përfundon procesi gjyqësor, se nuk mundemi me thënë se ky apo ai tjetri e ka mirë apo keq.

znj. Kadrije Lika Troni: Drejtori e tha se kjo nuk ka të bëjë me familjet, drejtori tha se kjo nuk e pengon me ardhur këtu me u trajtuar si pikë e rendit të punës.

z. Korab Krasniqi: Sqaroj për pronën që kërkohet me u këmbyer, ku është lokali, pronë e tushëve dhe pronë e beguncëve që kanë problem me tushët. Ata janë duke e kërkuar këtë pjesë, e jo atë që është në procedurë gjyqësore. Kjo pronë është krejt e veçantë.

z. Kjani Zeneli: Nëse legalizohet kjo pronë, ajo pronë tjetër a krijon telashe.

z. Korab Krasniqi: Jo nuk krijon.

znj. Kadrije Lika Troni: Ndërtimet që janë aty, krejt janë ilegale.

z. Korab Krasniqi: Unë i kam takuar paraprakisht familjet, dhe ata janë pajtuar që nuk kanë probleme dhe hyrja iu takon këtyre.

z. Kjani Zeneli: Sipas vizatimit po del se iu ngushtohet rruga familjes begunca që janë prapa objektit të tushëve.

znj. Ardita Rrahmani: Jo, rruga nuk iu ngushtohet.

z. Korab Krasniqi: Jo nuk iu ngushtohet rruga.

znj. Kadrije Lika Troni: A është e legalizuar pjesa të hyrja dhe dalja e tyre?

z. Korab Krasniqi: Prona me letra është e familjes begunca. Ka pasur daljen në anën e kundërt, tani është ndërtuar aty dhe kanë marrëveshje me kaluar nga ana tjetër. Unë i kam ftuar dhe iu kam thënë, bëni një marrëveshje të noteri, që në momentin që këmbëhet kjo pronë, me automatizëm me iu dalë kjo pronë këtyre, që mos me pasur telashe.

znj. Kadrije Lika Troni: Po, se këta me dashur, munden me bllokuar.

znj. Ernesta Krasniqi: Problemet mund të lindin edhe tek pasardhësit e tyre.

z. Kijani Zeneli: Kjo ndarje është me fjalë, ndërkaq dokument nuk kanë.

z. Korab Krasniqi: Këta kanë bërë me shkrim me këmbyer këtë pronë, ndërkaq sa kanë punuar në këtë drejtim, nuk e di. Ju vendosni a me shtyrë për një mbledhje tjetër apo me proceduar për KK.

Kryesuesi i Kuvendit: Çështja është mos me pasur problem në të ardhmen.

znj. Ardita Rrahmani: Krejt jemi për mos me pasur probleme në të ardhmen.

znj. Kadrije Lika Troni: Ne jemi mos me pasur problem, dhe interesin publik me e mbrojtur.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me 3 votë Për të PDK, 3 votë Kundër (LVV dhe VZHK), Abstenoj 1- Ardita Rrahmani-LDK. Meqë votat për dhe kundër mbetën të barabarta, atëherë Kryesuesi i Kuvendit e **shfrytëzoj votën shtesë "Për"** dhe kjo pikë kaloj. Konstatohet se Kuvendi i Komunës.

Aprovoj

Propozim Vendimin për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK Kaçanik. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora 12:10. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 07 anëtarët-të gjithë.

Mbledhja e V (pestë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës do të mbahet me 29.05.2026 (e premte) në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Malsiu

Kryesues i Kuvendit
Selajdin Troni

